



Misioni në Kosovë

Misionit të OSBE-së në

Kosovë i është besuar roli

udhëheqës për çështjet që

kanë të bëjnë me ndërtim

institucional dhe të

demokracisë, me shtet ligjor

dhe me të drejta të njeriut

në rajon. Misioni e formon

kështu një komponentë të

veçantë apo "degë" të

Administratës së Përkohshme

të Misionit të Kombeve të

Bashkuara në Kosovë

(UNMIK), dhe ndër të tjera

është përgjegjëse edhe për

trajnimin e administratorëve

të policisë, civil dhe ata të

drejtësisë; vazhdimin e

zhvillimit të shoqërisë civile;

përkrahjen e zhvillimit të

mediave; organizimin dhe

mbikqyrjen e zgjedhjeve; dhe

mbikqyrjen, mbrojtjen dhe

përparimin e të drejtave

të njeriut.



ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

Misioni në Kosovë

Qendra Burimore e Mbrojtjes Penale (CDRC)

Hyrje

Qendra Burimore për Mbrojtjen Penalo-Juridike (QBMPJ/ CDRC) u ofron ndihmë legale avokatëve mbrojtës në Kosovë. QBMPJ-ja është themeluar me bashkëpunimin e OSBE-së dhe Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) dhe ka filluar të veprojë si një organizatë joqeveritare (OJQ) në vitin 2001. QBMPJ-ja mbikqyret nga Bordi i Drejtorëve që përbëhet nga 5 avokatë mbrojtës kosovarë duke përfshirë anëtarë nga komunitetet më të vogla etnike dhe përfaqësuesit e katër organizatave ndërkombëtare: Zyra Amerikane në Prishtinë, OSBE-ja, Këshilli i Evropës dhe ABA-CEELI.



Aktivitetet

Mandati i QBMPJ-së është që të shërbejë si qendër burimore për t'u ofruar ndihmesë në raste avokatëve mbrojtës të Kosovës. QBMPJ-ja ndihmon avokatët mbrojtës për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarëve në çdo fazë të procedurës legale. Ndihmesa në raste kryesisht ofrohet në konteste të rënda penale, në veçanti ato që kanë të bëjnë me shkeljet e ligjit humanitar, krimet e motivuara politikisht/etnikisht dhe shkeljet e standardeve të të drejtave të njeriut. Stafi legal i QBMPJ-së ndërton strategji të përbashkët me avokatët për të zbatuar standardet e të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe për të sfiduar çdo shkelje të standardeve të tilla. Kjo qendër poashtu ua ofron avokatëve bibliotekën me materiale të shumta në lëmin e së drejtës ndërkombëtare. QBMPJ-ja poashtu ofron ndihmë teknike dhe logjistike ku është e nevojshme sidomos për avokatët minoritar. Për shkak të mandatit të saj, QBMPJ-ja si partner kryesor ka Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK). Me anë të ndihmesës në raste dhe trajnimeve, QBMPJ-ja përpiqet të forcojë kapacitetin e palës mbrojtëse.

Trajnimet dhe projektet

QBMPJ-ja herë pas here u ofron trajnime avokatëve mbrojtës për standardet ndërkombëtare për të drejtat njerëzore dhe shkathtësitë praktike. Përveç këtyre trajnimeve formale, juristët tanë udhëtojnë nëpër regjione të takohen me avokatë në grupe për diskutime joformale në lidhje me çështjet aktuale që ata hasin në rastet e tyre. Në këto grupe diskutimi, stafi i QBMPJ-së paraqet të drejtën relevante ndërkombëtare për t'i shqyrtuar çështjet.

Për informata të tjera, kontaktoni me

Zyrën për informim publik të OSBE-së, Prishtinë

Zyra e shtypit: +381 38 500 162 ext. 260

Zyra e informimit publik: +381 38 500 162 ext. 145

Fax: +381 38 500 188 E-mail: press@omik.org

Website: www.osce.org/kosovo

QBMPJ-ja poashtu bashkëpunon me OAK-un për çështjet që janë në interes të avokatëve. Kjo përfshin përpilimin e rregulloreve, hartimin e një diagrami të procedurës penale dhe mbledhje të ndryshme me organizata ndërkombëtare.

Të arriturat

Disa prej të arriturave të QBMPJ-së janë:

- Ka ndihmuar avokatët mbrojtës të të gjitha përkatësive etnike për zhvillimin e strategjisë së përgatitjes së rasteve dhe përgatitjen për gjykim, përpilimin e peticioneve, kërkimeve ligjore, përkthime, e tj.;
- Ka siguruar avokatë të duhur për të paraburgosurit e nënpërfaqësuar që kanë të drejtë për mbrojtje sipas ligjit;
- Ka shërbyer si ndërlidhje mes OAK-ut dhe UNMIK-ut në çështjet si pagesa me kohë dhe e duhur e avokatëve të emëruar nga gjykata, për qasjen e avokatëve me të paraburgosurit dhe të drejtën e avokatëve për të siguruar me kohë

dosjet nga gjykata dhe vendimet në shqip dhe serbisht;

- Ka organizuar transportimin e sigurtë për avokatët minoritar për t'i vizituar klientët e tyre dhe për t'u paraqitur në gjykatë.

Partneriteti

OSBE-ja ka ofruar infrastrukturën bazë, pajisjet dhe personelin e QBMPJ-së. Financimi aktual i QBMPJ-së bëhet nga një dhurim zemërgjerë i Qeverisë së SHBA-ve.

Stafi

Zyra e QBMPJ-së drejtohet nga një menaxher së bashku me menaxheren e financave dhe asistentin e zyrës/ shoferin. Stafi legal përbëhet prej dy juristëve ndërkombëtarë dhe tre juristëve kosovarë, të ndihmuar nga asistenti për ndërlidhje me minoritetet dhe dy përkthyes.

Prishtinë, 13 tetor 2003

Informata kontaktuese

Qendra Burimore e Mbrojtjes Penale
Bashkë Misioni i OSBE-së në Kosovë
Rruga e Beogradit 32, 38 000 Pristine
Tel: 038 245476
Fax: 381 0 38 229 350
OSCE Tel: 038 500 162, ext. 374/375/231
E-mail: ahmet.hasolli@omik.org

